

KULTURA 2023



Nr.15

BULETINI MUJOR / MARS

kultura.gov.al




PËRURORHET KULLA VENECIANE, QENDRA MË E RE E INFORMACIONIT PËR TRASHËGIMINË KULTURORE

Kulla Veneciane i rikthye publikut. Bashkë me zëvendës-presidentin e Komisionit Europian, Josep Borrell, përfaqësues të pushtetit lokal, ministria e Kulturës Elva Margariti përuroi punimet restauruese dhe rijetësuese në Kullën Veneciane në Durrës. Kjo ndërhyrje u bë e mundur falë programit të rindërtimit të monumenteve të kulturës pas tërmetit të vitit 2019, EU4CULTURE, zbatuar nga UNOPS, që jo vetëm ka nxjerrë në dritë një thesar, por i ka dhënë edhe më shumë vlerë falë teknologjisë. Tashmë ky monument kulture është shndërruar në një qendër informuese për historinë e qytetit në shërbim të

BUXHETI I VËNË NË DISPOZICION PËR REHABILITIMIN E KËTJË MONUMENTI TË RRALLË ËSHTË 700 MIJË EURO. NËDËRHYRJET E REALIZUARA PËRFSHINË GJITHË OBJEKTIN, QË NGA DYSHEMEJA, STRUKTURA, TARRACA, FASADA, DUKE HEQUR TË GJITHA SHTRËSËZIMET E PANEVOJSHME TË MBIVENDOSURA GJATË VITEVE DHE DUKE I RESTAURUAR ATO

vizitorëve shqiptarë e të huaj, e mbi të gjitha të rinjve. Buxheti i vënë në dispozicion për rehabilitimin e këtij monumenti të rrallë është 700 mijë euro. Ndërhyrjet e realizuara përfshinë gjithë objektin, që nga dyshemeja, struktura, tarraca, fasada, duke hequr të gjitha shtresëzimet e panevojshme të mbivendosura gjatë viteve dhe duke i restauruar ato. Po ashtu, u ndërhy edhe në sistemin elektrik të objektit. Aspektit monumental iu shtua edhe ai teknologjik, duke e kthyer Kullën Veneciane në shërbim të qytetit, përmes informacionit dhe orientimit në të gjithë hartën monumentale të Durrësit.



NISIN SONDAZHET ARKEOLOGJIKE NË AMFITEATRIN E DURRËSIT

Me vendim të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale ka nisur puna në hapësirat e amfiteatrit të Durrësit. Projekti madhor i gërmimit dhe restaurimit po paraprihet nga sondazhi arkeologjik dhe aplikimi i sondave gjeologjike vertikale dhe horizontale me qëllim njohjen më të mirë të shtresave nëntokësore, shtrirjen e monumentit, lidhjen e tij me truallin natyror, si dhe nivelin e ujërave nëntokësore. Rezultatet që po përftohen do të shërbejnë për hartimin e raporteve, të cilat do të krijojnë bazën e shëndoshë për vijimin e projektit për nxjerrjen në dritë të kësaj pasurie të jashtëzakonshme. Pavarësisht vështirësive të hasura për shkak të nivelit të lartë të ujërave nëntokësore, rezultatet paraprake janë të kënaqshme dhe në përputhje me parashikimet e bëra.




HAPET "FOTOTEKA", MUZEU VIRTUAL I FOTOGRAFISË

Me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës, me kontributin e koleksionistëve privatë, Fondacioni "Art & Histori" hapi muzeun virtual të fotografisë: "Fototeka" (www.fototeka.al). Mbi 7000 imazhe, ndarë në 7 periudha historike, shkrepur nga dhjetëra fotografë, kryesisht të juglindjes së Shqipërisë, por edhe të huaj, shpallorin më shumë se një shekull histori fotografike, por edhe të historisë së Shqipërisë. Përgjatë një viti u arrit të digjitalizohej një material i pasur fotografik, i shpërndarë në koleksione të ndryshme private brenda dhe jashtë vendit, i cili u pasurua me informacione të vlefshme për historinë e fotografisë shqiptare, kuruar nga studiuesi dhe historiani i artit Rubens Shima. "Fototeka" tashmë është në shërbim të publikut.

"MARUBI", NJË EKSPOZITË ME FOTOGRAFI TË FONDIT "DOKLE"

Muzeu Kombëtar i Fotografisë "Marubi" hapi ekspozitën me fotografi të realizuara nga Safet e Gjylzade Dokle. Imazhe të Shqipërisë së Veriut, fiksuar përgjatë 4 dekadave, vijnë përmes ekspozitës personale të "Safet e Gjylzade Dokle" të kuruar nga Lek M.Gjeloshi, hapur në Muzeun Kombëtar të Fotografisë "Marubi". Aktiviteti fotografik i bashkëshortëve Safet e Gjylzade Dokle u zhvillua kryesisht në Borje të Rrethit të Kukësit, duke përfshuar një hark kohor dyzetvjeçar, nga vitet '30 deri në fillim të viteve '70. Në koleksionin e tyre fotografik dokumentohet historia politike, jeta shoqërore, rritja e ndryshme dhe aspektet tradicionale të Shqipërisë Verilindore të asaj kohe. Ky koleksion, i cili përbëhet nga rreth njëzet mijë negativë, është më i madhi i dhuruar mbas viteve '90 në arkivin e Muzeut Kombëtar të Fotografisë "Marubi".



Objekte të trashëgimisë prehistorike nga Shqipëria janë bërë pjesë e një ekspozite ndërkombëtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Kanada. Mes një mozaiku të jashtëzakonshëm me objekte të 25 institucioneve nga 11 vende të Europës Juglindore janë edhe 17 artefakte, që datojnë nga 4 500 vjet më parë deri në 2400 vjet më parë, zbuluar nga varreza të ndryshme tumulare të gërmuara në gjithë territorin shqiptar. Janë objekte nga fondet e Institutit të Arkeologjisë dhe koleksioni i Muzeut Arkeologjik në Tiranë, të cilat janë bërë pjesë e ekspozitës lëvizëse në Amerikën e Veriut, organizuar nga një prej muzeve më të mëdhenj në SHBA, Field Museum of Natural History, në Çikago-SHBA. Një dëshmi mbi jetën politike e sociale në trojet tona në kohërat e "Mbretërve të parë të Europës".

SHQIPËRIA, PJESË E EKSPOZITËS "FIRST KINGS OF EUROPE" NË ÇIKAGO

Objekte të trashëgimisë prehistorike nga Shqipëria janë bërë pjesë e një ekspozite ndërkombëtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Kanada. Mes një mozaiku të jashtëzakonshëm me objekte të 25 institucioneve nga 11 vende të Europës Juglindore janë edhe 17 artefakte, që datojnë nga 4 500 vjet më parë deri në 2400 vjet më parë, zbuluar nga varreza të ndryshme tumulare të gërmuara në gjithë territorin shqiptar. Janë objekte nga fondet e Institutit të Arkeologjisë dhe koleksioni i Muzeut Arkeologjik në Tiranë, të cilat janë bërë pjesë e ekspozitës lëvizëse në Amerikën e Veriut, organizuar nga një prej muzeve më të mëdhenj në SHBA, Field Museum of Natural History, në Çikago-SHBA. Një dëshmi mbi jetën politike e sociale në trojet tona në kohërat e "Mbretërve të parë të Europës".

17 ARTEFAKTE

QË DATOJNË NGA 4 500 VJET MË PARË DERI NË 2400 VJET MË PARË. ZBULUAR NGA VARREZA TË NDRYSHME TUMULARE TË GËRMUARA NË GJITHË TERRITORIN SHQIPTAR, JANË BËRË PJESË E EKSPOZITËS.

TRASHËGIMI DHE VARGJE NË DITËN E BOTËRORE TË POEZISË

Aktivitetet me dashamirës të letërsisë, nxënës dhe yje të skenës shenjua Ditën Botërore të Poezisë në Tiranë. Një nga aktivitetet ishte ai i zhvilluar në oborrin e "Sarajevë", duke bërë bashkë trashëgiminë kulturore, muzikën dhe poezinë. Interpretimi i poezive të autorëve shqiptarë e të huaj nga aktorët e mëdhenj Viktor Zhusti, Yllka Mujo, Luiza Xhuvani, Ndrëçim Xhepa e Kastriot Çausi u shoqërua nga zëri këngëtares Vikena Kamenica, që solli disa nga këngët më të njohura shqiptare, kompozuar mbi vargje poezish të njohura të Kadaresë, Agollit, Kekos etj.



Të tjera aktivitete u zhvilluan me nxënës shkollash, ku mori jetë dhe nisura "Foleza e librit", një hapësirë ku kushdo mund të marrë një libër e të ndajë një libër, duke nxitur leximin dhe takimin me letërsinë. "Foleza" e parë u vendos pranë shkollës "Edith Durham", ku u zhvillua edhe një aktivitet me nxënësit e talentuar të kësaj shkolle dhe të rinjtë e Njësisë nr. 5.